



RAPORTI VJETOR 2014

Drejtoria e
Përgjithshme
e Parandalimit
të Pastrimit
të Parave

Republika e Shqiperise
Ministria e Financave

www.fint.gov.al
Ministria e Financave, Bulevardi “Deshmoret e Kombit”, nr 3,
Tirane, tel: +355 4 22 44 602

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| SHKURTIMET | 4 |
| MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM..... | 5 |
| HYRJE..... | 6 |
| DATAT KRYESORE..... | 7 |
| RAPORTIME | 12 |
| PËRFSHIRJA NË PROJEKTE KONFERENCA..... | 13 |
| MBIKËQYRJA DHE PËRPUTHSHMËRIA..... | 14 |
| Inspektimi | 14 |
| RAPORTIMI NGA SUBJEKTET E LIGJIT | 15 |
| Raporte të Aktivitetit të Dyshimtë..... | 15 |
| Raportimi i Transaksioneve në Para Fizike | 18 |
| ANALIZA E INFORMACIONIT..... | 18 |
| Blokimet e përkohshme | 26 |
| Ecuria e informacionit të dërguar në organet kompetente DPPSH | 27 |
| Masat kundër financimit të terrorizmit..... | 27 |
| BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL..... | 28 |
| BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR | 28 |
| Takime rajonale | 29 |
| Grupi EGMONT..... | 29 |
| Komiteti MONEYVAL..... | 30 |
| Shkëmbimi i informacionit me NJIF | 30 |
| MENAXHIMI I BURIMEVE | 31 |
| OBJEKTIVAT PËR VITIN 2015..... | 33 |

SHKURTIMET

| | |
|----------|--|
| AKSHI | - Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. |
| BE | - Bashkimi European. |
| DPD | - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. |
| DPPPP | - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. |
| DPPSH | - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. |
| DPT | - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. |
| EGMONT | - Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë. |
| FATF | - Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (Financial Action Task Force). |
| FMN | - Fondi Monetar Ndërkombëtar. |
| ILDKPKI | - Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. |
| KBLKPP | - Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave. |
| KiE | - Këshilli i Europës. |
| MONEYVAL | - Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave - KiE. |
| NjIF | - Njësi e Inteligjencës Financiare. |
| OJF | - Organizatë Jo Fitimprurëse. |
| PEP | - Person i Ekspozuar Politikisht. |
| RAD | - Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë. |
| RTPF | - Raporti i Transaksioneve në Para Fizike. |
| VKM | - Vendim i Këshillit të Ministrave. |
| ZKV | - Zyrë Këmbimi Valutor. |
| ZQRPP | - Zyra Qendrore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. |

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit janë vepra penale të cilat karakterizohen gjithnjë e më shumë nga dimensionimi transnacional, kompleksiteti i transaksioneve financiare që e mundësojnë fshehjen e origjinës së jashtëligjshme të fondeve apo pasurive si dhe gama e gjërë e aktorëve të përfshirë në fazat e ndryshme të procesit.

Efektet negative dhe rreziku që vepra të tilla përbëjnë për stabilitetin ekonomiko-financiar dhe kërcënimet në rritje për sigurinë kombëtare diktojnë nevojën e forcimit të vazhdueshëm të masave që vëndet në mbarë botën ndërmarrin për të konsoliduar sistemet e tyre parandaluese dhe goditëse. Përballja efektive më këto aktivitete të jashtëligjshme kërkon një koordinim dhe bashkëveprim të gjërë mes institucioneve publike dhe sektorit privat.

DPPPP është pjesë përbërëse e këtij sistemi, dhe ka një rol të veçantë në fazat parandaluese të fshehjes apo tjetërsimit të burimit të jashtëligjshëm të fondeve apo pasurive të siguruara nga aktiviteti kriminal. Përbushja e këtij roli mundësohet nëpërmjet raportimit të subjekteve që mbartin detyrimin ligjor në këtë drejtim, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit në organet kompetente që shoqërohet me hetimin e personave të përfshirë dhe konfiskimin e fondeve apo pasurive të tyre.

Raporti vjetor 2014, paraqet në vija të përgjithshme aktivitetin e zhvilluar nga DPPPP në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri. Ky aktivitet shumëplanësh është përqëndruar në drejtim të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me organet kompetente në vënd, rritjes së rrolit mbikëqyrës të subjekteve raportuese, kooperimit dhe koordinimit ndërinstytucional të punës në funksion të raportimit në organizmat ndërkombëtar si dhe shkëmbimit të informacionit me NjIF partnere.

Krahas sfidave të ndeshura në përbushjen e funksioneve të NjIF në Republikën e Shqipërisë, puna e DPPPP gjatë këtij viti ka shënuar progres në mbledhjen analizimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi pastrimin e produkteve të veprave penale, përmirësimin të vazhdueshëm të legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore dhe teknike, bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse dhe liçensuese dhe rritjen e nivelit të përputhshmërisë me rekomandimet e organizmave ndërkombëtar.

Në përmbyllje dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për bashkëpunimin me organet kompetente në vënd dhe NjIF partnere në nivel ndërkombëtar të cilat krahas punës dhe përkushtimit të punonjësve të DPPPP kanë luajtur një rol pozitiv në përbushjen e detyrimeve ligjore të institucionit.

Drejtori i Përgjithshëm

Genti GAZHELI

HYRJE

Viti 2014 është karakterizuar nga rritja e mëtejshme e kapaciteteve të DPPP në funksion të parandalimit të pastrimit të produkteve të aktivitetit kriminal dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri.

Raporti vjetor i DPPP, paraqet në mënyrë të detajuar punën e bërë dhe rezultatet që janë arritur deri më tani në sajë të përdorimit me efektivitet të burime njerëzore dhe teknike që disponojmë. Në sajë të këtyrë rezultateve kemi konsoliduar më tej kapacitetet tona për të siguruar të dhëna të vlefshme për organet e rendit në vëndin tonë të cilat përfshijnë informacione të natyrës operacionale, taktike dhe strategjike.

Roli parandalues i DPPP, në identifikimin dhe bllokimin e transaksioneve me elementë potencial për përfshirje në fshehjen apo tjetërsimin e origjinës së jashtëligjshme të tyre, ka njohur gjatë vitit 2014 një hop cilësor i cili do të vijojë të përbëjë një përvojë pozitive në funksionimin e mëtejshëm të institucionit dhe bashkëpunimin në këtë drejtim me organet kompetente.

Një vënd të rëndësishëm në punën tonë ka përbërë dhe bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional si një çështje e një rëndësie të veçantë për të siguruar një sistemi parandalues efektiv dhe njëkohësisht mbrojtjen e integritetit të sistemit financiar në vëndin tonë.

Rezultatet e punës së institucionit kanë ardhur gjithashtu si rrjedhojë e përdorimit me efikasitet të burimeve buxhetore duke synuar drejt një procesi transparence në prokurimin e fondeve publike të gërshetuar me llogaridhënien dhe monitorimin e vazhdueshmë për të siguruar funksionimin normal të punës institucionale.

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me NjIF partnere, pasqyrohet në të dhënat e detajuara për shkëmbimin e informacionit për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Një pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit ndërkombëtar ka qënë dhe përfaqësimi i vazhdueshëm i institucionet në takimet e organizmave ndërkombëtare që monitorojnë në mënyrë periodike nivelin e përputhshmërisë së vendit tonë me standartet ndërkombëtare (FATF, Moneyval).

Bazuar në përvojën më të mirë ndërkombëtar janë ndërmarrë hapa konkret në drejtim të orientimit të punës drejt analizave të riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel sektorial apo në shkallë vëndi gjë që do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet e punës së DPPP në të ardhmen.

DATAT KRYESORE

- Në maj të vitit 2000, Parlamenti Shqipëtar, pas kërkesave të KiE dhe të Komitetit MONEYVAL, miraton Ligjin nr. 8610 datë 17.05.2000 *“Për parandalimin e pastrimit të parave”*;
- Në Gusht të vitit 2001, krijohet për herë të parë Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (DBLKPP), në Ministrinë e Financave;
- Në Qershor të vitit 2003, Parlamenti Shqiptar, në zbatim të kërkesave të raportit të vlerësimit të dytë të Shqipërisë, nga Komiteti MONEYVAL, bënë disa ndryshime të rëndësishme të ligjit *“Për Parandalimin e Pastrimit të Parave”*, nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 9084 datë 19.06.2003 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”*”;
- Në Korrik të vitit 2003, DBLKPP bëhet anëtare me të drejta të plota në grupin EGMONT;
- Në Korrik të vitit 2004, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin nr. 9258 *“Për masat kundër financimit të terrorizmit”*;
- Në Gusht të vitit 2005, DBLKPP ngrihet në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave;
- Në Mars të vitit 2006, u publikua raporti i parë vjetor i DPPPP;
- Në Gusht të vitit 2006, KBLKPP miraton Programin Kombëtar të Kontrollit të Lëvizjes së Parasë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Në Nëntor të vitit 2006, miratohen Ligjet nr. 9641, datë 20.11.2006, *“Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Parandalimin e Terrorizmit”* dhe nr. 9646, datë 27.11.2006 *“Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe të Financimit të Terrorizmit”*;
- Në Janar të vitit 2008, me Urdhër të Kryeministrit të Shqipërisë, miratohet struktura e re e DPPPP, në të cilën krijohet për herë të parë Sektori i Teknologjisë së Informacionit;
- Në Maj të vitit 2008, Parlamenti Shqiptar miraton Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”* i cili hyri në fuqi në shtator të po atij viti;
- Në Shtator të vitit 2009, përfundon projekti i binjakëzimit *“Lufta kundër pastrimit të parave dhe krimin financiar”*, në bashkëpunim me Zyrën Kriminale Federale Gjermane;
- Në Tetor të vitit 2009, me Vendimin nr. 1077, date 27.10.2009, të Këshillit të Ministrave, miratohet Dokumenti Strategjik Kombëtar *“Për hetimin e krimin financiar”*, në hartimin e të cilit DPPPP kishte rrol drejtues;
- Në Nëntor të vitit 2009, DPPPP prezanton para Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare punën dyvjeçare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

- Në Nëntor 2010 u zhvillua vizita në vend e Misionit të 4-t Vlerësues të FMN-së, për masat e marra nga Shqipëria në fushën e parandalimit e goditjes së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Në Mars 2011 filloi projekti i dytë i binjakëzimit i financuar nga BE “*Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri*”;
- Në Mars 2011, Parlamenti Shqiptar, bën disa ndryshime të ligjit “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit*”, nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 10391 datë 03.03.2011;
- Në Prill 2011, Komiteti MONEYVAL i KiE miraton raportin e raundit të 4-t për Shqipërinë ku pasqyrohet vlerësimi në rritje për Rekomandimin 26 të FATF që lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë e DPPPP;
- Në Shkurt 2012, përfundoi vlerësimi i riskut mbi ekspozimin e sektorit të OJF në Shqipëri ndaj financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimin special VIII të FATF;
- Në Qershor 2012, u miratua nga Kuvëndi i Shqipërisë amendimi i Ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”;
- Në Tetor 2012, u përfundua dhe iu paraqit KBLKPP dokumenti për Vlerësimin Kombëtar të Riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Në muajin Prill 2013, përfundon projekti i BE “*Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri*”;
- Në muajin Korrik 2013, pjesëmarrja e drejtuesve të DPPPP në mbledhjen plenare të Grupit Egmont të NjIF;
- Në muajin Tetor 2013, DPPPP organizon konferencën rajonale të drejtuesve të NjIF;
- Në muajin Tetor 2013, Kuvëndi i Shqipërisë miraton ligjin “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”;
- Në Shkurt 2014, miratimi nga Kryeministri i vëndit i strukturës së re të DPPPP;
- Në Tetor 2014, takimi i KBLKPP nën kryesimin e Kryeministrit të vëndit;

REFORMA LEGJISLATIVE

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke i kushtuar rëndësi të veçantë përafritit të mëtejshëm të të legjislacionit shqiptar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në plotësim të akteve nënligjore të Ligjit nr. 157/2013 datë 10.10.2013, ka propozuar projekt udhëzimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për shpenzimet e lejueshme mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara të personave të shpallur”, udhëzim ky i miratuar nga Ministri Financave me Udhëzim nr. 1 datë 16.01.2014.

Ky projekt udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat për shpenzimet e lejueshme mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara të personave të shpallur sipas ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, në funksion të zbatimit të këtij ligji.

Me propozim të DPPPP është ndryshuar VKM 687/2011¹ për Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke përcaktuar administrimin e pasurive dhe fondeve të sekuestruara në zbatim të Ligjit nr. 157.

Në kuadër të ndryshimeve të ndodhura në fushën e veprimtarisë dhe kompetencave të disa ministrive, me synim rritjen e bashkëpunimit me Autoritetet Mbikëqyrëse për mbikëqyrje të subjekteve të ligjit dhe ndërgjegjësim të tyre, është propozuar ndryshim në Vendimin nr.343 datë 8.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”.

Për rritjen e nivelit të mbikëqyrjes së OJF-ve, nga Grupi Ndërinstitucional i Punës ku DPPPP ka pasur një rol aktiv, është propozuar dhe miratuar udhëzimi nr. 22, datë 19.11.2014 i Ministrimit të Financave “Për mbikëqyrjen e OJF-ve”.

Gjatë këtij viti, në zbatim të ligjit nr. 157, DPPPP ka ndjekur në vijimësi ndryshimet që pëson lista e personave të shpallur sipas vendimeve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të cilat janë miratuar me Vendimet nr. 14, datë 15.01.2014, nr. 37, datë 29.01.2014, nr. 226, datë 23.04.2014 nr. 649, datë 08.10.2014, nr. 799, datë 19.11.2014 dhe VKM-në nr. 855, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa në VKM nr. 718, date 29.10.2004, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.

NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE

Në përmbushje të detyrave që ngarkon ligji, DPPPP është treguar tepër aktive në drejtim të ndërgjegjësimit dhe trajnimit të subjekteve të ligjit, duke organizuar takime qoftë me subjektet e ligjit, ashtu dhe me autoritetet mbikëqyrëse.

Në këtë drejtim një ndikim të drejtëpërdrejtë ka pasur faqja zyrtare e DPPPP, në të cilën në vijimësi janë publikuar të dhëna që shërbejnë si burim informacioni për subjektet e ligjit, përfshirë këtu aktet ligjore dhe nënligjore, aktivitete dhe tipologji në fushën e parandalimit të pastrimit të parave etj.

¹ Ndryshim i miratuar me VKM nr. 324 datë 28.05.2014.

Në tabelën nr.1 paraqiten të dhënat për kategoritë dhe numrin e subjekteve të trajnuara në 3 vitet e fundit;

Tabela nr.1

| SUBJEKTI | NR. I PERSONAVE TË TRAJNUAR | | |
|---|-----------------------------|------------|------------|
| | VITI 2012 | VITI 2013 | VITI 2014 |
| Banka | 116 | 84 | 120 |
| ZKV | 179 | 151 | 70 |
| Institucione jo bankë | 50 | --- | 68 |
| Lojëra fati | -- | 15 | 12 |
| Noter | 71 | 75 | 237 |
| Avokat | 5 | --- | 0 |
| Ekspert Kontabël | 88 | 63 | 1 |
| Shoqëri sigurimi | 18 | --- | 0 |
| Autoritete Mbikëqyrëse dhe institucione (AMF, ZQRPP, DPPSH, DPD, DPT) | 37 | 13 | 139 |
| Shoqëri tregtimi të automjeteve | -- | --- | 14 |
| Shoqëri ndërtimi | --- | --- | 38 |
| Institute të pensioneve private | 3 | --- | 0 |
| TOTALI | 589 | 401 | 699 |

Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajnimit të subjekteve financiar bankare, nëpërmjet takimeve periodike të organizuara me bashkëpunimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Bankës së Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës, duke vënë ndër të tjera theksin dhe në përbushjen e detyrimeve të ligjit “Për masat kundër financimit të terrorizmit”. Specialistë të DPPPP kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga ana e bankave, institucioneve financiare jo-bankë dhe ZKV.

Në kuadër të zgjerimit të rrethit të subjekteve të trajnuar, evidentojmë trajnimet e organizuara gjatë vitit 2014 me shoqëri të tregtimit të mjeteve motorike si dhe seminarin trajnues me temë “Sistemi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe roli shoqërive të ndërtimit” të organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë.

DPPPP në bashkëpunim me përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Noterëve, ka organizuar trajnime me Dhomat e Noterëve Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Gjirokastrë dhe Korçë duke vënë theksin ndër të tjera në rolin thelbësor që kanë noterët si subjekt i ligjit.

Viti 2014 ka shënuar gjithashtu një intensifikim të takimeve trajnuese dhe me institucione shtetërore ku evidentojmë trajnime me ekspertë të AMF, trajnime me personat përgjegjës të ZQRPP, si dhe pjesëmarrja në cilësinë e lektorit në trajnime të organizuara nga Qendra e Formimit Policor me ekspertë të policisë, DPD dhe DPT.

MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESI I EKZEKUTIMIT TË TYRE

DPPPP përveç bashkëpunimit dhe trajnimit të subjekteve të ligjit, gjatë aktiviteti të saj është treguar e vëmendshme dhe me kontrollin e zbatueshmërisë së ligjit dhe akteve nënligjore nga ana e tyre. Në këtë këndvështrim janë vendosur masa administrative, si masë shtrënguese për detyrimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.

Përveç inspektive të kryera në vend është ndërmarrë një iniciativë në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit dhe mbikëqyrjes në vijimësi të përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve raportuese me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet inspektimit në distancë nga krahasimi i të dhënave të raportuara nga subjektet e ligjit.

DPPPP në ushtrim të kompetencave të saj ka vendosur masa administrative (gjobë) për shkeljet e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes së subjekteve.

Kundravajtjet administrative për subjektet e ligjit konsistojnë në;

- Shkelje të nenit 4, 4/1 dhe 5 të ligjit për identifikimin dhe mbajtjen e dokumentacionit të kërkuar për identifikim;
- Shkelje të nenit 11;
- Shkelje e nenit 12, pika 1, 2 dhe 3 të ligjit për raportimin e transaksioneve sipas këtij neni.

Tabela nr.2 përmban të dhënat mbi numrin dhe vlerat e gjobave sipas llojit të subjekteve të proceduara për tre vitet e fundit:

Tabela nr.2.

| SUBJEKTE | VITI 2012 | | VITI 2013 | | VITI 2014 | |
|--------------------------|--------------|------------------------|--------------|------------------------|--------------|------------------------|
| | Nr. i masave | Vlera e gjobave në LEK | Nr. i masave | Vlera e gjobave në LEK | Nr. i masave | Vlera e gjobave në LEK |
| Banka të Nivelit të Dytë | 1 | 4,000,000 | 2 | 8,500,000 | 5 | 4,430,000 |
| ZKV | 9 | 10,300,000 | 6 | 5,700,000 | 7 | 4,300,000 |
| Noterë | 2 | 600,000 | 5 | 1,700,000 | 29 | 9,700,000 |
| Institucione Jo Bankë | 2 | 2,500,000 | 0 | 0 | 2 | 800,000 |
| Lojëra Fati | 1 | 500,000 | 0 | 0 | 3 | 2,500,000 |
| Shoqëri Ndërtimi | 7 | 6,900,000 | 0 | 0 | 11 | 6,800,000 |
| TOTALI | 22 | 24,800,000 | 13 | 15,900,000 | 57 | 28,530,000 |

Tabela nr.3 paraqet në mënyrë krahasimore masat administrative dhe arkëtimet e tyre gjatë periudhës 2012 – 2014, në të cilën vërehen qartë treguesit në rritje.

Tabela nr.3.

| ZËRAT | Viti 2012 | Viti 2013 | Viti 2014 |
|--|------------|------------|------------|
| Vendime për gjoba | 22 | 13 | 57 |
| Subjekte që kanë arkëtuar vullnetarisht | 5 | 7 | 35 |
| Shuma totale e vlerës së gjobave | 24,800,000 | 15,900,000 | 28,530,000 |
| Shuma e vlerës së arkëtuar për gjobat e vitit 2014 | 7,200,000 | 10,600,000 | 18,170,000 |
| Shuma e vlerës së arkëtuar për gjobat e mbartura | 11,169,890 | 6,061,000 | 16,065,705 |
| Shuma totale e arkëtuar | 18,369,890 | 16,661,000 | 34,235,705 |

Gjatë vitit 2014, janë arkëtuar në total 34 235 705 lekë nga të cilat 18 170 000 lekë janë arkëtime nga masat administrative të vendosura në vitin 2014 dhe 16 065 705 lekë arkëtime të masave administrative të vendosura në vitet e mëparshme. Nga të dhënat statistikore për vitin 2014 vërehet gjithashtu një rritje e ndjeshme e nivelit të pagesave në mënyrë vullnetare.

DPPPP i ka kushtuar vëmendje të veçantë ndjekjes së proceseve gjyqësore për masat administrative të vendosura për subjektet raportuese apo çështje të tjera që lidhen me funksionimin e institucionit.

Pas evidentimit të të gjithë praktikave gjyqësore në proces, si dhe për të nxitur procesin e ekzekutimit të gjobave të vendosura gjatë vitit 2014, DPPPP i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesa për lëshim urdhërash ekzekutimi për 43 subjekte.

RAPORTIME

Në datën 1 Tetor 2014 u zhvillua nën drejtimin e Kryeministrit të vendit mbledhja e KBLKPP në të cilën merrnin pjesë në cilësinë e anëtarëve Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Punëve të Brendshme, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, Ministri i Financave, Zv/Ministri i Mbrojtjes, Zv/Ministri i Drejtësisë dhe i DPPPP.

Në këtë mbledhje Drejtori i Përgjithshëm i DPPPP zt.Genti GAZHELI, raportoi në lidhje me veprimtarinë e institucionit të shoqëruar më të dhëna statistikore, progresin e bërë në drejtim të rritjes së numrit dhe volumit të shumave të bllokuara e sekuestruara, të informacioneve për çështjet e pastrimit të parave/financimit të terrorizmit të dërguara në organet kompetente, konsolidimin e procesit të trajnimeve të subjekteve raportuese, marrëdhëniet me NjIF partnere dhe organizmat ndërkombëtare që monitorojnë nivelin e përputhshmërisë së vendit tonë. Gjatë kësaj mbledhje u miratua dhe rregullorja “Për funksionimin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave”.

PËRFSHIRJA NË PROJEKTE DHE KONFERENCA

Në kuadër të bashkëpunimit me DPPSH ekspertët e DPPPP, kanë marrë pjesë në cilësinë e lektorit në trajnimet e mëposhtëme, të organizuara nga Qendra e Formimit Policor:

- Në datën 18.03.2014 në aktivitetin me temë “*Procedurat dhe teknikat hetimore për zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parave*”;
- Në datën 22.09.2014 në aktivitetin me temë “*Lufta kundër krimit të pastrimit të parave, zbatimimi i instrumenteve ekzistues dhe zhvillimi i mëtejshëm për të luftuar, pastrimin e parave dhe sekuestrimin e pasurive*”;
- Në datën 30.10.2014 në aktivitetin me temë “*Konsolidimi i kapaciteteve për një luftë efikase kundër pastrimit të parave, zbulimit e sekuestrimit të pasurive*”;
- Në datën 23 Shtator 2014 konferencë ndërkombëtare e organizuar nga KiE/BE në Prishtinë Kosovë. Përfaqësuesi i DPPPP në këtë konferencë prezantoi një panoramë kronologjike të krijimit dhe zhvillimit të institucionit, legjislacionit Shqipëtar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, raste konkrete të bashkëpunimit me NjIF si dhe përvojën e DPPPP në shkëmbimin e informacionit.

MBIKËQYRJA DHE PËRPUTHSHMËRIA

Inspektimi

Inspektimi në vënd apo në distancë i subjekteve të ligjit, përbën një prej funksioneve të DP-PPP me të cilin synohet të mbikëqyret niveli i përputhshmërisë së subjekteve raportuese me detyrimet e parashikuara në legjislacionin Shqipëtar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ky proces është bazuar në analizën e riskut të kategorive të subjekteve, në mënyrë që mbikëqyrja të përqëndrohet në sektorët më të ekspozuar ndaj pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Një qasje e tillë ka ndikuar në konsolidimin e mëtejshëm të sistemit në tërësi dhe ka rritur aftësinë parandaluese të subjekteve.

Mbikëqyrja e subjekteve raportuese kryhet përmes inspektimeve në vënd/distancë, shqyrtimit të raporteve të dërguara dhe informacioneve të administruara nga subjektet raportuese dhe autoritetet mbikëqyrëse. Për një mbikëqyrje sa më efektive, DPPPP i kushton rëndësi bashkëpunimit me këto autoritete duke kryer inspektime të përbashkëta dhe shkëmbyer konkluzionet përkatëse.

Në tabelën nr.4 paraqiten të dhënat e kategorizuara të inspektimeve për vitin 2014 të krahasuara me vitet 2012 dhe 2013:

Tabela nr.4

| Nr. | Subjektet e Inspektuara | Viti 2012 | | Viti 2013 | | Viti 2014 | |
|-----|--------------------------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|
| | | Në Vënd | Në Distancë | Në Vënd | Në Distancë | Në Vënd | Në Distancë |
| 1 | Banka | 5 | | 7 | | 7 | |
| 2 | Institucione Fin.Jo-Bankë | 6 | 24 | | | 3 | 1 |
| 3 | ZKV | 20 | 87 | 2 | 110 | 19 | 8 |
| 4 | Shoqëri Ndërtimi | 15 | 4 | | 10 | 18 | |
| 5 | Noterë | 6 | 54 | 1 | 19 | 4 | 82 |
| 6 | Lojëra Fati | 7 | 45 | | | 3 | |
| 7 | Metale të çmuara | 2 | | | | 3 | |
| 8 | EKA | | 45 | | 27 | 3 | 16 |
| 9 | Imobiliare | | 2 | | 8 | 2 | |
| 10 | Mjete Motorike | | 19 | | | 8 | 1 |
| 11 | Sigurimi i Jetës | | 3 | | | 1 | |
| 12 | Instituti i Pensioneve Private | | 3 | | | | |
| 13 | Agjenci Udhëtimi | | | | | 1 | |
| | Shuma | 61 | 286 | 10 | 174 | 72 | 108 |
| | TOTAL | 347 | | 184 | | 161 | |

Procesi i inspektimi të subjekteve, është paraprirë nga një fazë planifikimi me anë të të cilit është synuar të evidentohen mangësitë dhe përcaktuar më pas rekomandimet konkrete për masat që subjektet duhet të ndër marrin në vijimësi, për të siguruar rritjen e nivelit të përputhshmërisë.

Në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur disa nga mangësitë kryesore të evidentuara gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së subjekteve:

- Zbatimi i raportimit të transaksioneve të kryera në para fizike mbi pragun e përcaktuar në ligj;
- Procesi i identifikimit të klientëve dhe mos ruajtja e këtyre dokumenteve në përputhje me parashikimet ligjore;
- Cilësinë dhe sasinë a analizave të transaksioneve komplekse dhe të pa justifikuara nga pikëpamja ekonomike;
- Niveli i ushtrimit të masave të “*Vigjilencës së zgjeruar*” për kategoritë e klientëve të konsideruar me risk të lartë;
- Mënyra e organizimit apo nivelit të funksionimit të një sistemi të centralizuar për ruatjen dhe analizimin e të dhënave;
- Mos ushtrimi i detyrimeve ligjore për kontrollin e brëndshëm të subjektit;

MBLEDHJA DHE ANALIZIMI I INFORMACIONIT

Siç dihet funksioni themelor i një njësisë së inteligjencës financiare si DPPPP është mbledhja, analizimi i informacionit të subjekteve të ligjit (duke mos u kufizuar vetëm në informacionin e ardhur por duke kryer kërkime në të dhënat e brendshme dhe rast pas rasti duke siguruar të dhëna me kërkesa) dhe më pas në rastet kur ka dyshimet mbeten të tilla, rastet referohen në organet kompetente.

RAPORTIMI NGA SUBJEKTET E LIGJIT

RAPORTET E AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

RAD janë një nga burimet kryesore të informacionit që NjIF, marrin nga subjektet e ligjit. Në tabelën nr.5 pasqyrohen RAD të raportuara në DPPPP nga subjektet e ligjit në periudhën 2009-2014.

Tabela nr.5

| SUBJEKTI | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|---|------------|------------|------------|------------|------------|--------------|
| Banka | 142 | 163 | 329 | 352 | 420 | 822 |
| Shoqëri transfertash | | 3 | 7 | 73 | 45 | 74 |
| DPD | 5 | 15 | 20 | 30 | 36 | 48 |
| DPT | 2 | 1 | | 33 | 10 | 50 |
| ZQRPP | | | 8 | 29 | 20 | 64 |
| Noter | | 6 | 17 | 19 | 15 | 122 |
| ZKV | | | 1 | 14 | 8 | 16 |
| ILDKPKI | | | | 2 | 0 | 6 |
| Shoqëri auditimi | | | | 0 | 1 | 0 |
| Ekspert kontabël | | | 1 | 0 | 1 | 4 |
| Institucione financiare të Mikrokredisë | | | | | | 2 |
| Avokat | | | | 1 | 1 | 2 |
| Tjetër | 3 | 18 | | 2 | 1 | 3 |
| Shoqëri të qeradhënies financiare | | | | 1 | 0 | 4 |
| Shoqëri ndërtimit | | | | | | 4 |
| Shoqëri tregtimi mjetesh motorike | | | | | | 9 |
| Total | 152 | 211 | 383 | 556 | 558 | 1,230 |

Nga të dhënat e tabelës vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të RAD, të raportuara në DPPPP nga subjektet e ligjit. Për vitin 2014, ky numër është dyfishuar në krahasim me vitin e mëparshëm.

Rritja sasiore e numrit të RAD, është shoqëruar me një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së këtyre raporteve dhe zgjerim të kategorive të subjekteve raportuese. Shtimi në vitin 2014 i rasteve për të cilat subjektet raportuese kanë kërkuar miratim paraprak përbën gjithashtu një zhvillim cilësor si një tregues domethënës i forcimit të aspektit parandalues.

Nga vlerësimi i RAD të dërguara nga subjektet bankë në vitet 2013-2014 rezulton se:

- nga 420 RAD e raportuara në vitin 2013, është kërkuar leje për kryerjen e transaksioneve nga DPPPP, për 41 prej tyre (10%);
- nga 822 RAD e raportuara në vitin 2014, është kërkuar leje nga DPPPP për kryerje transaksioni për 143 prej tyre (17.3%);

Këto raportime kanë pasur ndikim të dukshëm në procesin parandalues, pasi në vijim të analizimit të tyre DPPPP ka nxjerrë urdhra për bllokim të përkohshëm të cilat janë shoqëruar më pas me sekuestime me vendime të Prokurorisë dhe Gjykatës.

Përveç bankave, gjatë vitit 2014 ka një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2013, në numrin e RAD të dërguara nga shoqëritë e transfertave, shoqëri të tregtimit të mjeteve motorike, ZKV, DPT, DPD, ILDKPKI dhe ZQRPP.

Një vënd të veçantë për RAD e vitit 2014 e zënë subjektet noter të cilët kanë dërguar 122 RAD, që përbën më se dyfishin e RAD të dërguara në vitet 2010-2013 (57 RAD). Krahasuar me vitin 2013 përmirësim evidentohet gjithashtu edhe në raportimin e RAD, nga ekspert kontabël, shoqëri ndërtimi, shoqëri të qeradhënies financiare.

Statistika e mësipërme është një nga treguesit më të prekshëm të një sistemi parandalues i cili nga viti në vit ka përmirësim, pavarësisht se sfidat dhe mënyrat e reja për të kryer pastrim parash dhe/apo financim terrorizmi janë gjithnjë në evolucion të vazhdueshëm.

Elementët kryesor që kanë kontribuar në rritjen e numrin të RAD dhe kërkesave paraprake janë:

- sensibilizimi i subjekteve raportuese, nëpërmjet trajnimeve dhe takimeve të përbashkëta;
- mbikëqyrja e subjekteve dhe masat administrative;
- reagimi për subjektet e ligjit;
- tipologjitë e prezantuara;
- bashkërendimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe shoqatat e subjekte për të trajtuar problematikën e konstatuar;

Bazuar në analizën e të dhënave të RAD të raportuara në DPPPP gjatë periudhës 2010 – 2014, në mënyrë të përmbledhur ato mund të kategorizohen sipas tipologjive të tabelës nr.6

Tabela nr.6.


| Tipologjia e RAD | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|--|------------|------------|------------|------------|--------------|
| Transferta të dyshimta me/nga jashtë | 63 | 141 | 218 | 189 | 282 |
| Derdhje me para në dorë në shuma të konsiderueshme | 30 | 53 | 60 | 96 | 112 |
| Përdorimi i llogarisë individuale për qëllime biznesi/evazion fiskal | 53 | 62 | 52 | 44 | 407 |
| Veprime jashtë profilit të klientit | 11 | 18 | 29 | 60 | 55 |
| Dyshime lidhur me aktivitete të import/eksportit të mallrave | 6 | 16 | 19 | 13 | 0 |
| Deklarim/Mos deklarim të vlerave në kufi | 4 | 5 | 11 | 23 | 48 |
| Mashtrim dhe mashtrim kompjuterik | 11 | 9 | 1 | 4 | 13 |
| Përfshirje të PEP në transaksione | 6 | 5 | 9 | 0 | 10 |
| Dyshime për financim terrorizmi | 4 | 1 | 3 | 4 | 8 |
| Sponsorizime/dhurime/dhënie huaje nga/për të tretë | 4 | 0 | 15 | 18 | 42 |
| Blerje pasurish të paluajtshme me burim të panjohur të fondeve | | 11 | 37 | 29 | 142 |
| Blerje pasurish të luajtshme me burim të panjohur të fondeve | | 8 | 7 | 0 | 16 |
| Mos identifikimi i pronarit përfitues | | 11 | 24 | 1 | 3 |
| Veprime/Transaksione të mbetura të tentativë | | 6 | 17 | 26 | 23 |
| Transaksione të kryera nga OJF | | 2 | 5 | 4 | 5 |
| Kryerja e një aktiviteti ekonomik fiktiv | | | 23 | 5 | 2 |
| Transaksione të kryera nga /drejt kompanive të lojërave të fatit | | | 7 | 2 | 3 |
| Veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale | | | 0 | 9 | 15 |
| Përdorimi i instrumenteve bankare me anomali/ falsifikuar (letër kredi/çek, etj) | | | 5 | 4 | 3 |
| Përdorim i dyshimtë i kredive bankare | | | 3 | 8 | 9 |
| Këmbime valutore në vlera të larta | | | | | 10 |
| Tjetër | 19 | 35 | 11 | 23 | 22 |
| Total | 211 | 383 | 556 | 558 | 1,230 |

Procesi i kategorizimit të tipologjive ka një rol të rëndësishëm, në funksion të përcaktimit të prioriteteve të DPPPP për analizimin e informacionit dhe shpërndarjen e mëtejshme tek autoritetet kompetente, rishikimin e vlerësimit kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe mbikëqyrjes së subjekteve raportuese.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE

Raportimi i transaksioneve në para fizike vijon të jetë gjithashtu një burim i rëndësishëm i informacionit që subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dërgojnë në DPPPP. Në grafikun nr.1 paraqiten të dhënat në lidhje me ecurinë e këtij raportimi për periudhën 2010 – 2014.


Grafiku nr.1 Raportimi i transaksioneve në para fizike.



ANALIZA E INFORMACIONIT

Bazuar në analizimin e informacionit të marrë në përputhje me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, DPPPP për vitet 2012 -2014 ka informuar organet kompetente sipas të dhënave të paraqitura në grafikun nr. 2.

Grafiku nr. 2. Referimet në organet kompetente



Gjatë vitit 2014 numri i referimeve për Policinë e Shtetit dhe/apo Prokurorinë është rritur me 63 % (462/2014 kundrejt të 283/2013). Një pjesë e këtyre referimeve janë shoqëruar dhe me urdhëra bllokimi përkohshëm. Vlera totale e transaksioneve të bllokuara është rreth 18 milion Euro, nga të cilat rreth 15 milion Euro janë sekuestruar me vendim gjykatë/prokurorie.

Burimet e informacionit për referimet që DPPPP ka bërë në vitin 2014, në organet kompetente paraqiten në tabelën nr.7:

Tabela nr.7.

| Indicia | RAD | RTPF | Analize sektoriale | NjIF partnere | Njoftime | Total |
|------------------------|------------|-----------|--------------------|---------------|-----------|------------|
| Referimet ne Prokurori | 109 | 6 | 5 | 8 | 20 | 148 |
| Referimet ne Polici | 212 | 16 | 60 | 6 | 20 | 314 |
| TOTALI | 321 | 22 | 65 | 14 | 40 | 462 |

Siç vërehet në tabelë, afro 70% e rasteve të referuara në organet e zbatimit të ligjit kanë si burim RAD e subjekteve të ligjit. Analiza sektoriale e informacionit ka qënë gjithashtu një burim i rëndësishëm i informacionit gjatë vitit 2014, nga i cili kanë rezultuar 14% të totalit të referimeve.

Totali i RAD të referuara (321) në 2014, paraqitet i kategorizuar sipas subjektit raportues, në tabelën nr.8:

Tabela nr.8.

| Referuar | RAD BANKA | RAD Shoqëri transfertash | RAD NOTER | RAD Instit. Shtetërore | Tjetër | Total |
|--------------|------------|--------------------------|-----------|------------------------|----------|------------|
| Prokurori | 82 | 11 | 8 | 8 | 0 | 109 |
| Polici | 115 | 46 | 13 | 32 | 6 | 212 |
| Total | 197 | 57 | 21 | 40 | 6 | 321 |

Bazuar në këto të dhëna vlen të evidentohet se 61% e RAD të referuara janë raportuar nga bankat ndërkohë që 18% të RAD të referuara janë nga shoqëritë e transfertave.

Megjithëse DPPPP, është NjIF e tipit administrativ (pa kompetenca hetimi), mbi bazë të të dhënave konfidenciale apo nga burime të hapura, ka arritur të përcaktojë lidhjen e mundshme me veprën e origjinës për një pjesë të rasteve të referuara, të cilat paraqiten të kategorizuara në tabelën nr.9 për periudhën 2012-2014.

Tabela nr.9 Të dhënat mbi veprën e origjinës.

| Vepra e origjinës | 2012 | 2013 | 2014 |
|--|------------|------------|------------|
| Nuk përcaktohet | 116 | 196 | 300 |
| Trafikim të lëndëve narkotike | 30 | 18 | 50 |
| Mashtrim/ Falsifikim | 16 | 17 | 20 |
| Fshehje të ardhurash/Evazion fiskal | 15 | 28 | 40 |
| Korrupsion | 9 | 7 | 7 |
| Grabitje/vjedhje | 5 | 2 | 10 |
| Trafikim i mjeteve motorike | 5 | 2 | 2 |
| Trafikim qëniesh njerezore/shfrytëzim prostitucioni | 4 | 4 | 9 |
| Precedent penal të tjerë | 3 | 3 | 15 |
| Vrasje | | | 2 |
| Mos deklarim ne kufi | | | 4 |
| Kontrabandë dhe prodhim/shitje e lëndëve të rrezikshme | 2 | 1 | |
| Procedim penal për pastrim parash | | 2 | |
| Dyshime për financim terrorizmi | | 1 | 3 |
| Krijim organizate kriminale | | 1 | |
| Kambizëm i palicënsuar | | 1 | |
| Totali | 205 | 283 | 462 |

Nga të dhënat e kategorizuara konstatohet se mbizotërojnë rastet për të cilat vepra penale e origjinës nuk ka qenë e mundur të përcaktohet, për të cilat nga analiza e informacionit është konkluduar se:

- fondet e qarkulluara nuk kanë patur burime të ligjshme;
- veprimet financiare kanë patur anomali të dukshme;
- qëllimi ekonomiko-ligjor ka qenë bindshëm i dyshimtë,
- kanë pasur ngjashmëri të theksuara me tipologjitë e njohura ndërkombëtare.

Nga rastet për të cilat ka qenë e mundur të individualizohet vepra e origjinës, peshën kryesore e zënë trafikimi i lëndëve narkotike, fshehja e të ardhurave/evazion fiskal, mashtrimi, falsifikimi, trafikimi i qënieve njerëzore, korrupsioni etj. Për 50 raste të lidhura me evazionin fiskal DPPPP ka informuar DPT për të ndërmarrë veprime të mëtejshme.

RASTE STUDIMORE

Në kuadrin e rritjes së mëtejshme të kapaciteteve parandaluese të subjekteve të ligjit, në vijim paraqiten disa tipologji të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit të cilat kanë qënë subjekt i punës së DPPPP.

TRANSFERTA NDËRKOMBËTARE NË VLERA TË KONSIDERUESHME


Bazuar në legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit DPPPP u informua nga subjektet e ligjit se shtetasi Shqipëtar (shtetasi A), rezident në një vënd Evropian (X), ishte përfitues i transfertave në shumën totale 700,000 Euro nga një kompani (Kompania B) që operonte në vëndin (Y) llogaritë e së cilës ishin të hapura në institucione financiare të vëndit (Z). A kërkoi që brënda një kohe të shkurtër nga mbërritja e fondeve, të kryente veprime kembimi valutator dhe tërheqje në para fizike.

Bazuar në faktin se fondet e transferuara ishin në vlerë të konsiderueshme dhe vinin nga një vënd që konsiderohej me risk për çështjet e pastrimit të parave, DPPPP ndërmorri një analizim të hollësishëm të informacionit prej të cilit rezultoi se:

- Shtetasi 'A' jetonte prej shumë kohësh në vëndin 'X' ku ishte i përfshirë në disa aktivitete biznesi;
- Burime të hapura përmbanin të dhëna për përfshirje në një grup të strukturuar kriminal me aktivitet ndërkombëtar;
- Përfaqësuesit e kompanisë 'B', figuronin si persona të lidhur me një skandal korrupsioni në një vënd Evropian;

Në përmbushje të rrolit parandalues DPPPP, nxorri një urdhër bllokimi të përkohshëm dhe dërgoi informacionin e disponuar në organet kompetente bazuar në anomalitë e konstatuara në analizimin e transaksioneve si dhe lidhjet me akte korruptive jashtë vëndit.

Nga reagimi i organeve kompetente, DPPPP është informuar se në bazë të urdhërit të bllokimit të DPPPP, u vendos sekuestro preventive mbi fondet.



PËRFSHIRJE E PERSONAVE TË LIDHUR NË FSHEHJEN E ORIGJINËS SË FONDEVE

Bazuar në kërkesat e legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, DPPPP është informuar nga subjekte të ligjit se një shtetas shqiptar (shtetësi A) ishte dërgues i një numri të konsiderueshëm transfertash nga një vënd Europian. Përfitues të këtyre transfertave në Shqipëri ishin ndër të tjerë dhe të afërm të personit.


DPPPP bazuar në shumën totale dhe shpeshtësinë e transfertave të urdhëruara nga 'A', ndër-mori një analizë më të detajuar të të dhënave që disponohen për 'A' dhe personat e lidhur.

Në kuadrin e verifikimeve të kryera në këtë kontekst rezultoi se një nga personat e lidhur (shtetasi B), i evidentuar si person i përfshirë në aktivitet të jashtëligjshëm kishte transferuar gjithashtu shuma të konsiderueshme tek të njëjtit përfitues në Shqipëri.

Në funksion të analizës financiare të informacionit DPPPP, kërkoi të dhëna shtesë nga subjektet e ligjit, regjistrat publik të një sërë institucionesh shtetërore si dhe Njësi partnere të Inteligjencës Financiare.

Informacioni në lidhje me shumën e konsiderueshme, frekuencën e transfertave drejt Shqipërisë, përfshirjen e 'B' në aktivitet të jashtëligjshëm si dhe të dhënat shtesë të siguruar në sajë të shkëmbimit të informacionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ju dërguan për investigim të mëtejshëm organeve kompetente.

Nga reagimi që DPPPP merr në lidhje me informacionin e dërguar është informuar nga ana e organit kompetent se shtetasi 'B' është subjekt i hetimit penal në kuadrin e të cilit është nxjerrë dhe vendim sekuestrimi.



PERSON I EKSPOZUAR POLITIKISHT (PEP)


DPPPP u njoh me faktin se një person i ekspozuar politikisht (PEP) përfitoi në llogarinë e tij bankare donacione në shumën 1 milion Euro nga Lindja e Mesme.

Nisur nga fakti se shtetasi përfitues i fondeve ishte PEP, çështja ju nënshtrua një analize të hollësishme nga DPPPP në lidhje me arsyen e transferimit të fondeve, përdorimin e tyre, si dhe historikun e veprimeve financiare të personit.

Nga analizimi i informacionit rezultoi se:

- fondet e dërguara si donacione, në një pjesë të madhe kanalizoheshin nëpër llogaritë e tij personale dhe jo drejt destinacionit përfundimtar;
- në vitin 2010 PEP kishte blerë kuotat e një shoqërie 'C' në vlerën 2 milion LEK, të cilat i shiti pas një viti për një shumë të konsiderueshme;
- kishte blerë një pasuri të paluejtshme me çmim 2.5 milion Eur së bashku me persona të tjerë të cilët jetonin në Lindjen e Mesme;
- kishte depozituar mbi 500,000 EUR me para në dorë në llogaritë e tij personale, si dhe të një shtetasi tjetër (shtetasi A), prej të cilës kishte blerë një apartament;
- shtetasi A, ndërkohë kishte të depozituara në llogari mbi 150,000 EUR, si dhe kishte investuar shuma të konsiderueshme për hapjen e një biznesi shërbimesh;

DPPPP dërgoi rastin për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit, me dyshime për korrupsion, duke vënë theksin në faktin se investimet e konsiderueshme në pasuri të paluejtshme dhe aktivitet biznesi nuk ishin të justifikuar nga burime të ligjshme.




TË ARDHURA TË SIGURUARA NGA AKTIVITET I JASHTËLIGJSHËM

Subjektet e ligjit kanë informuar DPPPP mbi aktivitet të dyshimtë të shtetasit 'A', i cili kishte kryer një sërë transaksionesh të cilat nuk përputheshin me profilin e klientit. Transaksionet konsistonin në depozitime të shumave të konsiderueshme në para fizike burimi i deklaruar i të cilave ishte shitja e pasurisë së paluejtshme dhe të ardhurat nga emigracioni.

Bazuar në këto të dhëna paraprake DPPPP, vijoi me analizimin e mëtejshëm të informacionit në të cilën përfshiheshin të dhënat e raportuara nga subjektet e ligjit si dhe të dhëna shtesë të siguruar në sajë të bashkëpunimit ndërinstytucional nga i cili rezultoi se:

- Në llogaritë e shtetasit ishin kryer transaksione të konsiderueshme nga shtetasi B (vëllai i shtetasit A, banues në një shtet European) dhe nga shtetasi 'C';
- Nga të dhënat e zyrës së gjëndjes civile u konstatua se shtetasi 'C' ishte vëllai i shtetasit 'A', por si pasojë e ndryshimit të emrit identifikimi i lidhjes mes tyre nuk kishte qënë i mundur që në fazat fillestare të analizës së informacionit;

Nga komunikimi me organet e rendit DPPPP u informua në lidhje me faktin se 'B', kishte qënë i përfshirë në aktivitet të jashtëligjshëm. Të dhënat e analizimit të këtij informacioni ju shpërndanë në mënyrë spontane NjIF homolog ndërkohë që informacioni i detajuar i analizës së DPPPP, ju dërgua për investigim të mëtejshëm DPPSH.



PËRFSHIRJE NË AKTIVITET TË REKRUTIMIT TË PERSONAVE PËR QËLLIME TERRORIZMI

Në përputhje me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, DPPPP është informuar në lidhje me persona të dyshuar për përfshirje në aktivitet të jashtëligjshëm "rekrutimin e personave për kryerjen e veprave terroriste".

Në funksion të ndjekjes me prioritet të kësaj çështje DPPPP ka vendosur marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me organet kompetente në vënd si dhe në kuadrin e analizimit të informacionit, janë kërkuar nga subjektet e ligjit të dhënat që për personat e përfshirë si dhe është bashkëpunuar me institucionet shtetërore për të siguruar informacion nga regjistrat publik.

Masat e sipërpërmëndura synonin krijim e një panorame më të qartë të shtrirjes së aktivitetit të personave të përfshirë, aktivitetit të tyre të biznesit si dhe pasurive të paluejtshme të regjistruar në emër të tyre apo të personave të lidhur.

Në sajë të analizimit të shpejtë të informacionit rezultoi se burimi kryesor i të ardhurave të këtyre personave sigurohej nga;

- aktivitet biznesi;
- pasuri të paluejtshme;
- ndërkohë që nga të dhënat e subjekteve financiare vëreheshin transaksione në shuma modeste.
- Në informacionin që DPPPP hartoi në lidhje me konkluzionet e informacionit të analizuar rezultuan të dhëna mbi:
- Lidhjet e personave të përfshirë me entitete jashtë vëndit;
- Itenerare udhëtimesh;
- Deklarime të parave fizike në pikat e kalimit të kufirit të shoqëruara me destinacionin e përdorimit të tyre.

- Çështja në fjalë është subjekt investigimi nga organet kompetente.
- Konkluzionet e nxjerra.
- Rëndësia në rritje e bashkëpunimit mes personave të kontaktit të institucioneve të përfshira në parandalimin dhe goditjen e aktivitetit kriminal;
- Roli i bashkëpunimit me subjektet e ligjit, në sajë të të cilit përveç të dhënave financiare u siguruan dhe të dhëna mbi lidhjet potenciale të personave të përfshirë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar;
- Njohja e mëtejshme e mënyrë së veprimit së grupimeve të tilla si dhe hartimi i analizave strategjike;

Blokimet e përkohshme

DPPPP bazuar në nenin 22, të ligjit nr.9917 dt.19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar, në kuadrin e përbushjes së funksionit parandalues, urdhëron, kur ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për pastrim parash dhe financim terrorizmi, bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar. Tabela nr. 10 paraqet të dhënat e udhërave të bllokimit, shumën e bllokuar dhe sekuestruar për periudhën 2009 - 2014.

Tabela nr.10

| Vitet | Nr. i Urdhër Bllokimeve | Totali në LEK i bllokuar | Totali në LEK i sekuestruar | % e Sekuestrimeve mbi Bllokimet |
|---------------|-------------------------|--------------------------|-----------------------------|---------------------------------|
| 2009 | 23 | 702,664,198 | 590,337,613 | 83.9 |
| 2010 | 23 | 181,589,247 | 132,983,006 | 66.5 |
| 2011 | 13 | 226,731,196 | 122,097,477 | 53.5 |
| 2012 | 8 | 181,589,247 | 160,434,099 | 88.3 |
| 2013 | 15 | 123,336,890 | 29,893,265 | 24.2 |
| 2014 | 65 | 2,545,726,400 | 1,955,487,800 | 76.8 |
| TOTALI | 147 | 3,961,637,178 | 2,991,233,260 | 75.5 |

Për vitin 2014 janë nxjerrë 65 urdhra bllokimi të përkohshëm, me një vlerë totale prej rreth 18 milion Euro, nga të cilat rreth 15 milion Euro janë sekuestruar me vendim gjykatë/prokurorie, shifra këto që tejkalojnë bindshëm të gjitha bllokimet dhe sekuestrimet e të viteve 2009-2013 të mbledhur së bashku².

² Për vitet 2009-2013 vlera totale e urdhrave të bllokimit është 1,415,910,778 Lek ndërsa sekuestrimet janë 1,035,745,460 Lek. Vetëm viti 2014 vlera totale e urdhrave të bllokimit është 2,545,726,400 Lek ndërsa sekuestrimet janë 1,955,487,800 Lek

Ecuria e informacionit të dërguar në organet kompetente DPPSH

Bazuar në të dhënat statistikore të dërguara nga DPPSH në lidhje me ecurinë e rasteve të referuara nga DPPPP, rezulton se:

- në vitin 2012, nga 114 referime të kryera nga DPPSH në Prokurori për pastrim parash, 70 prej tyre kanë si indicie informacionet e dërguara nga DPPPP.
- në vitin 2013, nga 85 referime të kryera nga DPPSH në Prokurori për pastrim parash, 46 prej tyre kanë si indicie informacionet e dërguara nga DPPPP.
- ndërsa në vitin 2014, nga 205 referime të kryera nga DPPSH në Prokurori për pastrim parash, 130 prej tyre kanë si indicie informacionet e dërguara nga DPPPP.

SEKTORI I ANALIZËS STRATEGJIKE

Në vitin 2014 puna e Sektorit të Analizës Strategjike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ka konsistuar në:

- Përgatitja e raportimeve për Komitetin MONEYVAL të KiE, FATF), BE dhe institucione të tjera ndërkombëtare;
- Rishikimi i procesit të vlerësimit kombëtar të riskut të PP/FT;
- Analiza strategjike e të dhënave të shoqërive të transfertave;
- Evidentimin e të dhënave mbi subjektet me risk që i nënshtrohen procesit të inspektimit;
- Pjesëmarrja në trajnime apo aktivitete ndërkombëtare të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit;
- Shkëmbimi i informacionit me Njësitë homologe të Inteligjencës Financiare (nëpërmjet rrjetit *Egmont Secure Web*);
- Monitorimi në mënyrë periodike i transaksioneve komplekse dhe atyre në para fizike dhe analizimin e tyre;
- Monitorimi i procesit të zbatimit nga subjektet e ligjit të detyrimeve të përcaktuara në ligjin “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”;
- Ndjekje të çështjeve që kanë të bëjnë me Komitetin Ndërinstitucional për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

Masat kundër financimit të terrorizmit

Një nga detyrat e DPPPP është analizimi dhe referimi i rasteve të dyshuara për financim terrorist, e cila ka një natyrë komplekse për vetë faktin se transaksionet financiare të përdorura në një sërë sulmesh terroriste në nivel ndërkombëtar janë në shumën relativisht modeste.

Bazuar në masat e marra në kuadrin e reformës legislative dhe harmonizimit që bëhet me rekomandimeve ndërkombëtare, vendi ynë ka tashmë një legjislacion të plotë përpara i përket parandalimit dhe goditjes së financimit të terrorizmit i cili përcakton kompetencat dhe marrëdhëniet e organeve përgjegjëse për propozimin, miratimin, kontrollin dhe zbatimin detyrimeve që lindin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si dhe detyrimin për raportim të rasteve të dyshimta për financim të terrorizmit nga subjektet, institucionet dhe çdo person që disponon një informacion të tillë.

Në këtë kontekst, ligji “Për masat kundër financimit të terrorizmit” i jep mundësi Këshillit të Ministrave që të vendosë përfshirjen me iniciativë të entiteteve të veçanta në listën e personave të shpallur, proces ky që ka karakter administrativ dhe jo gjyqësor. Krahas rritjes së përputhshmërisë me normat ndërkombëtare ky ligj ofron garanci të plotë për të drejtën e ankimit për personat e përfshirë.

Gjatë këtij viti i është kushtuar në vijimësi rëndësi e veçantë trajnimit të subjekteve për identifikimin, analizimin dhe raportimin nga e tyre e rasteve të dyshuara për financim të terrorizmit, takimeve me organet kompetente në vënd duke synuar rritjen e efektivitetit të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit të shpejtë dhe cilësor me NjIF partnere.

BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL

Viti 2014 ka shënuar hapat të rëndësishëm në rritjen e mëtëjshme të bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë e Përgjithshme, e cila pasqyrohet në trajtimin e shpejtë dhe me efektivitet të rasteve për të cilat pas indicies dhe urdhërave të bllokimit të përkohshëm të DPPPP është proceduar me shpejtësi nga Policia e Shtetit e më pas nga Prokuroria në lidhje me marrjen e masave parandaluese për tjetërsimin e fondeve.

Përveç rasteve të cilat DPPPP referon në Polici/Prokurori, në mënyrë të vazhdueshme merr kërkesa prej tyre dhe kthen përgjigje për persona në hetim. Tabela nr.11 paraqet të dhënat për kërkesat (dhe numrin e personave të përfshirë) që DPPPP ka marrë në vitin 2014.

Tabela nr.11

| | Kërkesat | Nr.Personave |
|--------------|-----------------|---------------------|
| Prokurori | 250 | 1917 |
| Polici | 122 | 647 |
| TOTAL | 372 | 2564 |

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Konferenca rajonale e NJIF

Në datat 20-21 Tetor 2014 është zhvilluar në Podgoricë të Malit të Zi, konferenca e VIII rajonale e drejtuesve të NjIF të Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Shqipërisë.

Disa nga çështjet kryesore të trajtuara këtë konferencë ishin:

- Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër PP/FT;
- Shkëmbimi i informacionit ndërmjet njësive të inteligjencës së rajonit;
- Tipologjitë e reja në fushën e përdorimit të parasë elektronike, rreziqet që ato mbartin dhe masat që mund të merren në këtë drejtim;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe metodologjisë së FATF, me theks të veçantë për Rekomandimin 1, i cili ka të bëjë me vlerësimin kombëtar të riskut;
- Kriteret për përcaktimin e PEP, anëtarët e familjes, personat e lidhur dhe përvoja ndërkombëtare në këtë drejtim;

Në këtë konferencë përfaqësuesit e DPPPP, bënë një prezantim mbi misionin, modelin dhe rolin e drejtorisë, funksionin mbikëqyrëse, teknologjinë e informacionit, analiza strategjike, puna e bërë për vlerësimin kombëtar të rriskut, përcaktimi ligjor i PEP në Shqipëri si dhe bashkëpunimi me ILDKPKI. Në përfundim të kësaj konference u përcaktuan dhe masat e mëtejshme në funksion të forcimit të bashkëpunimit rajonal.

Takime rajonale

Gjatë këtij viti grupe pune të DPPPP të kryesura nga Drejtori i Përgjithshëm kanë zhvilluar takime pune me NjIF të Kosovës, Greqisë dhe Italisë, me të cilat janë shkëmbyer eksperiencat e deritanishme të bashkëpunimit dypalësh, përvoja në zbatimin e rekomandimeve të FATF dhe parimeve të Grupit EGMONT, analizën operacionale dhe strategjike të informacionit, risqet me të cilat vëndet e rajonit përballen si pasojë e terrorizmit ndërkombëtar etj.

Grupi EGMONT

Në kuadrin e bashkëpunimit me grupin Egmont DPPPP, ka marrë pjesë në takimet e grupeve të punës dhe seancën plenare të zhvilluara gjatë këtij viti, rezultatet e të cilave paraqiten në vijim.

Në datat 17 – 19 Shkurt 2014 u zhvilluan në Budapest takimet e grupeve të punës së Egmont në të cilin DPPPP është përfaqësuar rregullisht. Në datën 19.02.2014 Grupi Mbështetës diskutoi çështjen e anëtarësimit të NjIF së Kosovës në Grupin EGMONT gjë për të cilën DPPPP ka pasur një angazhim maksimal. Në këtë takim ndër të tjera u diskutuan dhe një sërë dokumentesh të rëndësishme për punën e këtij grupi të cilat i shërbejnë punës së mëtejshme të DPPPP.

Në datat 01. – 06.06.2014 u zhvillua në Lima të Perusë mbledhja e 22 plenare e Grupit EGMONT, në të cilin përfaqësues të nivelit të lartë në DPPPP, kanë marrë pjesë aktive në takimet e Grupit Mbështetës në të cilin ka vijuar diskutimi në kuadrin e anëtarësimit të NjIF Kosovë.

Një vënd të rëndësishëm në këtë seancë kishte dhe diskutimi i standardeve të Grupit EGMONT dhe zbatimi i tyre nga NjIF, përputhshmëria me rekomandimet e FATF, takimet me drejtuesit e delegacioneve të vëndeve anëtare, shkëmbimi i eksperiencave të vëndeve të FATF që i janë nënshtruar procesit të vlerësimit sipas metodologjisë së vitit 2013 si dhe pranimi i njësive të reja si anëtare të Grupit Egmont.

Në kuadrin e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me organizmat ndërkombëtar DPPPP, në vitin 2014 ka vijuar të luajë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së objektivave të planit të veprimit dhe raportimin periodik që është bërë për këtë qëllim në grupet e punës së FATF. Një vënd të veçantë në mbarëvajtjen e këtij procesi ka pasur shkëmbimi i informacionit dhe bashkëveprimi me Ministrinë e Drejtësisë, Bankën e Shqipërisë dhe AMF.

Komiteti MONEYVAL

Përfaqësuesit e DPPPP, kanë marrë pjesë rregullisht në seancat plenare që Komiteti Moneyval i Këshillit të Europës ka zhvilluar në muajt prill, shtator dhe dhjetor 2014. Vlen të theksohet se në seancën e muajt dhjetor DPPPP i është besuar dhe kryesimi i delegacionit Shqipëtar në këtë komitet.

Nga ana e DPPPP përpos përgatitjes dhe dërgimit brënda afateve të kontributeve përkatëse për raportimet periodike është bashkëpunuar dhe koordinuar puna dhe me Bankën e Shqipërisë, AMF, Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe DPPSH.

Shkëmbimi i informacionit me NJIF

Shkëmbimi i informacionit me NjIF partnere ka vijuar të jetë një faktor i rëndësishëm në punën e DPPPP. Në kushtet e natyrës ndërkombëtare të krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit, ky proces luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në drejtim të monitorimit të flukseve të transaksioneve dhe fondeve të siguruara në mënyrë të jashtëligjshme duke siguruar një veprim të koordinuar ndërkombëtar mes organeve kompetente. Në tabelën nr. 12 paraqiten të dhënat mbi shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit që DPPPP ka pasur me NjIF partnere për periudhën 2012 - 2014.

Tabela nr.12

| | Kërkesa nga NJIF | Kërkesa nga DPPPP | Përgjigje nga NjIF | Përgjigje nga DPPPP |
|------|------------------|-------------------|--------------------|---------------------|
| 2012 | 50 | 38 | 18 | 40 |
| 2013 | 56 | 35 | 28 | 70 |
| 2014 | 62 ¹ | 66 ² | 50 | 48 |

Në vitin 2014 ka pasur një tendencë të qëndrueshme të krahasuar me vitet e mëparshme për sa i përket shkëmbimit spontan të informacionit me NjIF partnere. Ky proces përbën një nga tiparet dalluese të bashkëpunimit ndërkombëtar, bazuar në parimet e Grupit EGMONT dhe rëndësinë në rritje që i kushtohet ndërveprimit proaktiv në rekomandimet dhe metodologjinë e FATF.

Krahasuar me periudhat e mëparshme, ka mbizotëruar bashkëpunimi më NjIF e Greqisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar, Belgjikës, SHBA, Kanadasë dhe Australisë. Gjatë këtij viti DP-PPP ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me NjIF e Bangladeshit dhe Sri-Lankës të cilat mundësojnë shkëmbimin e informacionit më këto njësi.


MENAXHIMI I BURIMEVE

DPPPP gjatë vitit 2014 i ka kushtuar vëmendje të veçantë procesit të zbatimit të detyrimeve të legjislacionit “Për statusin e nëpunësit civil” dhe në këtë kontekst është bashkëpunuar ngushtësisht me Departamentin e Administratës Publike në funksion të riskstrukturimit të institucionit.

Në këtë kuadër nëpunësit në periudhë prove i janë nënshtruar trajnimit të detyrueshëm të organizuar nga Shkolla Shqipëtare e Administratës Publike në të cilat janë trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me kushtetutën, të drejtat e njeriut dhe parimet e funksionimit të administratës publike, procedurat administrative dhe komunikimi, etika dhe konflikti i interesit, organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike, integrimi Evropian dhe strukturat Euroatlantike, aftësitë administrative dhe zbatimi i legjislacionit të shërbimit civil në Republikën e Shqipërisë. Burimet buxhetore që i janë vënë në dispozicion DPPPP kanë qënë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e funksionimit normal të institucionit.

Në grafikun nr. 3 paraqiten të dhënat e burimeve buxhetore dhe përdorimit të tyre nga DPPPP për periudhën 2009 – 2014.

Grafiku nr. 3



¹ Prej të cilave 10 janë informacione spontane.

² Prej të cilave 21 janë informacione spontane.

Nga të dhënat e këtij grafiku konstatohet qartë mbështetja e vazhdueshme që DPPPP ka pasur në funksion të realizimit të detyrës saj si NjIF në Republikën e Shqipërisë.

Në kuadrin e rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore trajnimi i punonjësve të DPPPP ka një rëndësi të dorës së parë dhe në këtë kontekst ka pasur pjesëmarrje aktive në aktivitetet e mëposhtme të zhvilluara brënda dhe jashtë vëndit.

- Trajnim më temë “*Investigimi Financiar dhe procesi i identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale*” i organizuar nga Qendra Rajonale e Anti-Korrupsionit në Sibiu të Rumanisë në datat 01 - 07 Qershor 2014. Në këtë trajnim të organizuar për vëndet e Europës Jug-Lindore morën pjesë dy ekspertë të DPPPP;

Tematika e këtij trajnimit përfshinte procesin e identifikimit, të sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të pasurive kriminale, instrumentet kombëtarë dhe ndërkombëtarë për konfiskimin e pasurive, mekanizmat e ndihmës së ndërsjellë ligjore etj;

- Trajnim i Zyrës Kundër Drogës dhe Narkotikëve të OKB (UNODC) në Ohër të Maqedonisë në datat 23-25 Shtator 2014, me temë “*Transportimi ndërkufitar i parave fizike*” në të cilin morën pjesë dy ekspertë të DPPPP. Përpos ekspertëve nga vëndi në këtë takim kishte dhe përfaqësues nga Bosnje Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia;

Tematika e trajnimit përfshinte çështje të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; sistemit të deklarimit në pikat kufitare dhe detyrimet që lindin nga rekomandimi 32 i FATF; roli që NjIF dhe organet e rendit kanë në këtë drejtim; raste studimore si dhe roli i burimeve të hapura në hetimin financiar të mos-deklarimit apo deklarimit të rremë;

- Trajnim me temë “*Analiza Strategjike për Njësitë e Inteligjencës Financiare*” i organizuar në Strasburg të Francës në datat 25-29 Gusht 2014, në të cilin mori pjesë një përfaqësues i DPPPP. Tematika e trajnimit përfshinte të menduarit kritik dhe rolin e tij në analizën e informacionit nga ana e NjIF; produktet e analizës strategjike; cikli i i analizimi të informacionit etj;
- Trajnim në Tiranë në datat 18-23 Shtator 2014, i organizuar në sajë të bashkëpunimit të AMF, FSVC³ dhe USAID⁴ në të cilin mori pjesë një ekspert i DPPPP. Çështje kryesore të këtij trajnim kishin të bënin me: verifikimin e burimit të kapitalit për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësit në momentin e liçencimit dhe gjatë ushtrimit të aktivitetit; mbikëqyrjen e kompanive të sigurimit përmes inspektimit për përputhshmërinë e aktiviteteve të tyre me dispozitat e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave; shkëmbimin e praktikave më të mira dhe identifikimin e rasteve të dyshuara për pastrim parash;
- Konferencë e organizuar nga qendra SELEC⁵ në bashkëpunim me UNODC, në Bukuresht të Rumanisë në datat 27-28 Nëntor 2014. Tema e kësaj konference ishte “*Flukset e jashtëligjshme financiare*” dhe në të merrnin pjesë ekspertë të organeve të rendit dhe NjIF nga vendeve anëtare të SELEC. Në këtë konferencë DPPPP përfaqësohej nga një eksperte dhe tematika e trajtuar kishte të bënte me trafikimin e lëndëve narkotike në rrugën

³ Korpusi i Asistencës Financiare (Financial Services Volunteer Corps).

⁴ Agjensia e Qeverisë së SHBA për asistencën ndërkombëtare.

⁵ Qendra e Evropës Juglindore të Organeve të Rendit (Southeast European Law Enforcement Center).

ballkanike dhe pastrimi i parave; instrumentet kombëtarë dhe ndërkombëtarë për parandalimin e pastrimit të parave; ndihma e ndërsjellë ligjore midis shteteve me qëllim parandalimin dhe luftën kundër trafikut të lëndëve narkotike;

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Në funksion të dixhitalizimit të informacionit nga ana e DPPPP, gjatë vitit 2014 ka vijuar puna për të siguruar funksionimin normal të moduleve të raportimit nga subjektet e ligjit, gjë që ndër të tjera është realizuar nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të organizuara për këtë qëllim si dhe rishikimit të manualeve të raportimit.

Sigurimi i informacionit në rrugë elektronike ka njohur zhvillime pozitive kryesisht në bashkëpunimin me ZQRPP, ILDKPKI, DPPSH dhe Ministrinë e Drejtësisë. Njëkohësisht ka pasur një zgjerim të numrit të subjekteve që kanë qasje në modulet e raportimit elektronik, me 84 përdorues të rinj ndër të cilët përfshihen noterët, kompani ndërtimi, zyra vendore të ZQRPP, kompani të shitjeve të makinave, institucione financiare jo bankare dhe argjendari.

Në kuadrin e informimit publik faqja zyrtare e DPPPP i është nënshtruar një procesi rishikimi dhe rikonceptimi duke mundësuar njëkohësisht dhe aksesin e sigurtë të subjekteve raportuese. Në këtë kontekst ne vijimësi është siguruar përditësimi i informacionit në lidhje me aktivitetin e DPPPP, janë publikuar raportet, udhëzues, praktikat më të mira dhe dokumente të rëndësishme të organizmave ndërkombëtar (FATF, Grupi Egmont, OKB dhe Komiteti MON-EYVAL).

Rritja e sigurisë së marrjes dhe ruajtjes së informacionit ka qënë gjithashtu një nga drejtimit kryesor të punës së DPPPP në vitin 2014. Kjo është arritur nëpërmjet ruajtjes periodike të të dhënave sensitive, sistemeve të monitorimit, funksionimit normal të pajisjeve kompjuterike, mbrojtjes nga risqet kibernetike apo ndërhyrjet e pautorizuara në informacion etj.

Ekspertët e DPPPP janë përfshirë gjithashtu gjatë kësaj periudhe në takime dhe seminare trajnuese të organizuara nga institucionet vëndase (AKSHI) apo projektet ndërkombëtare (ICITAP⁶) të cilat kanë ndikuar në rritjen e mëtejshme të kapaciteteve njerëzore.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2015

Në kuadrin e përmbushjes të prioriteteve të aktivitetit të saj, DPPPP ka përcaktuar objektivat kryesor të punës për vitin 2015, të cilët do të konkretizohen në planin vjetor të punës, bashkëpunimin ndërinstitucional, zbatimin të dokumentave strategjik dhe raportimeve periodike në institucionet ndërkombëtare:

- Konsolidimi i mëtejshëm i rolit mbikëqyrës të DPPPP;

⁶ Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin në Hetimet Penale – Departamenti i Shtetit SHBA (*International Criminal Investigative Training Assistance Program*).

- Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe informimi i KBLKPP;
- Rritja e kapaciteteve parandaluese të orientuara në qasjen mbi bazën e riskut;
- Rritja e mëtejshme e kapaciteteve njerëzore dhe përdorimi efektiv i burime buxhetore dhe teknike;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i nivelit të përputhshmërisë së DPPP me rekomandimet e organizmave ndërkombëtar;
- Kontribut në rritje në kuadrin e bashkëpunimit më NjIF rajonale;